

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË



Punim i diplomës master

Diversiteti i faunës së peshqve në pellgun e lumit Ibër

Kandidati:

Ardita Berisha

Mentori:

Prof. Dr. Linda Grapci Kotori

Prishtinë, 2025

ABSTRAKTI

Ky punim ofron një vlerësim gjithëpërfshirës të faunës së peshqve në pellgun e lumit Ibër, me synim të krijimit të një baze të saktë për hulumtime të mëtejme. Hulumtimi u realizua në 10 lokalitete përgjatë rrjedhës së poshtme të lumit gjatë periudhës Mars - Qershor 2024.

Për analizën e ihtiofaunës u përdoren metoda sasiore dhe cilësore, duke përfshirë llogaritjen e indeksave e indeksave dhe diversitetit dhe parametrave fiziko-kimik të ujit. Uidentifikuan gjithsej 22 lloje peshqish të ndara në 9 familje, me familjen Leuciscide që përfaqëson me numrin më të madh të llojeve, gjithsej 7. Ndër lokalitetet e studiuara Revatskë (L10) dhe Liqeni akumulues (L6), rezultuan më të pasurat me lloje, ndërsa Liqeni i Ujmani (L3), u vlerësua me biodiversitetin më të ulët, duke reflektuar ndotje të lartë dhe kushte ekologjike më pak të favorshme. Matjet e parametrave fiziko-kimik treguan se temperatura e ujit varioonte nga 6.1 gradë celsius (Milloshevë) deri në 8.1 (Nadakoc), ndërsa vlerat e oksigjenit të tretur ishin më të larta në Ibër poshtë digës, 9,90 mg/L, dhe më të ulëta në Nadakoc 2.80 mg/L.

Indeksat e diversitetit treguan variacione të rëndësishme mes lokaliteteve me vlerën më të lartë të indeksit të Shanon ëienerit në liqenin akumulues, 2.37, dhe vlera më e ulët në Ibër poshtë digës, 0.00.

Bazuar në këto rezultate mund të konstatojmë se pjesa e poshtme e lumit Ibër paraqet një ekosistem me kushte të përshtatshme ekologjike dhe një biodiversitet të pasur të ihtiofaunës së peshqve.